



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0035820/25 dt. 10.06.25
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 8, 10, dhe nenin 31 paragrafi 2.6 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0035820/25, dt. 20.06.2025 të Drejtorisë për Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve në bazë të Njoftimit Publik për Subvencionimin dhe Montimin e Serrave të Tipit Tunel me sipërfaqe 50 m² me Material Përcjellës për Fermerët)

- 1. Formohet** Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve në bazë të Njoftimit Publik për Subvencionimin dhe Montimin e Serrave të Tipit Tunel me sipërfaqe 50 m² me Material Përcjellës për Fermerët në bazë të Njoftimit Publik Nr. 03-030/01-0034754/25, dt. 17.06.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1** Elvira Xhemajli – kryesuese (DBZHR);
 - 1.2** Xhevahire Boshnjaku – anëtare (DBZHR);
 - 1.3** Mirsada Fejzullahi – anëtare (DBZHR).
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e të gjitha aplikacioneve/kërkesave që janë dorëzuar për përfitimin e subvencioneve, transfereve dhe granteve për projektin “Subvencionimin dhe Montimin e Serrave të Tipit Tunel me sipërfaqe 50 m² me Material Përcjellës për Fermerët” në përputhje me kriteret e Njoftimit Publik Nr. 03-030/01-0034754/25, dt. 17.06.2025, Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve si nga aspekti procedural, po ashtu dhe ai përmbajtjesor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga momenti i mbylljes së Thirrjes Publike.
- Gjatë fazës së vlerësimit Komisioni obligohet që të mbajë Procesverbal nga momenti i hapjes së procesit e deri në marrjen e Vendimit, duke përfshirë dhe pikët me rastin e vlerësimit.

5. Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni duhet të sjell Vendim, i cili duhet të përfshij kërkesat e miratuara dhe ato të refuzuara, ku ky Vendim duhet të publikohet në ueb faqen e Komunës.
6. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: kriteret e Njoftimit Publik, Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
7. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e fazës së vlerësimit.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

- 1x1 Propozim - Vendimi Nr. 01-020/04-0035820/25, dt. 20.06.2025 të Drejtorisë për Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
- 1x1 Njoftim Publik Nr. 03-030/01-0034754/25, dt. 17.06.2025

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit